



QENDRA KOMBËTARE  
E BIZNESIT  
Nr. 7129 Prot.  
Datë 20.5.2019



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË  
"DE NOVO" sh.p.k

NIPT L31911021F

Adresa: Rruga "Frederik Shiroka", Pallatet Gora", Kulla 3, Shkalla 1, kati 2, Nr.1, Tiranë  
Cel: +355 693041355 e-mail: info@denovo.al

Nr. 469/2 Prot  
Nr. 0279-18 Regj

Tiranë më, 15/05/ 2019

URDHËR  
"PËR VENDOSJEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE"

Drejtuar: Qendra Kombëtare e Biznesit  
Adresa: Tiranë  
Per dijeni: Debitorit : Shoqëria "XYZ 08" sh.p.k, NIPT: K92110004Q, Adm. Sami Seit Sharka  
Adresa: Tirane Njesia bashkiake nr 11, rruga "Lord Bajron", banese private nr 14, Laprakë  
Kreditor : Agjencia Kombetare e Burimeve Natyrore (AKBN)  
Adresa: Bulevardi "Bajram Curri", Blloku "Vasil Shanto", Tirane

Pranë Studios Permbarimore "DE NOVO" shpk, me kërkesë të palës kreditore është regjistruar çështja përmbarimore me numër 0279-18 regj dhe me palë:

Kreditor : Agjencia Kombetare e Burimeve Natyrore (AKBN)  
Debitorit : Shoqëria "XYZ 08" sh.p.k, NIPT: K92110004Q, Adm. Sami Seit Sharka  
Objekti : Likuidim gjobe

KONSTATOVA:

Për titullin ekzekutiv "Mase Administrative Nr.5688 Prot, datë 16/06/2014" është lëshuar Urdhri i Ekzekutimit Nr.1238 (31100-05840-80-2015) Regj.Them, datë 30/09/2015 i Gjykatës Administrative të Shkalles se Pare Tiranë", me palë kreditore Agjencia Kombetare e Burimeve Natyrore (AKBN) dhe palë debitore Shoqëria "XYZ 08" sh.p.k, NIPT: K92110004Q, Adm. Sami Seit Sharka dhe Sami Seit Sharka dtl. 01.06.1957.

Me vendim të përmbaruesit gjyqësor privat, mbështetur dhe në nenin 519 të K. Pr. Civile është kaluar në ekzekutim të detyrueshëm të titullit ekzekutiv, rrjedhimisht për ekzekutimin e tij, duhet të kryhet verifikimi dhe vendosja masës së sekuestros në QKB, mbi aktivin që zotëron pala debitore.

Për këtë arsye në bazë të neneve 527 e në vijim të K.Pr.Civile dhe nenit 39 të Ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për Kundravajtjet Administrative".

URDHËROJ:

1. Vendosjes e masës së sekuestros konservative në aksionet, kuotat e debitorit Shoqëria "XYZ 08" sh.p.k, NIPT: K92110004Q, Adm. Sami Seit Sharka dhe Sami Seit Sharka dtl. 01.06.1957 si dhe mbi të drejtat që rrjedhin nga zotërimin e këtyre aksioneve/kuotave duke ndaluar tjetërsimin dhe/ose disponimin e tyre si dhe mos kryerjen e asnjë veprimi tjetër i cili mund të ndryshojë të dhënat e regjistrit tregtar. Dokumentacioni do të qëndrojë i bllokuar deri në një urdhër të dytë.
2. Vendosjen e masës së sekuestros konservative në të tjera aksione/kuota të cilat zotërohen nga pala debitore Shoqëria "XYZ 08" sh.p.k, NIPT: K92110004Q, Adm. Sami Seit Sharka dhe Sami Seit Sharka dtl. 01.06.1957 në shoqëritë e tjera të regjistruara pranë regjistrit tregtar.
3. Për veprimin apo mosveprimin tuaj, duhet të na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.
4. Për personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdhri do të merren masat e parashikuara në nenet 606 e vijues të K. Pr. Civile, si dhe në rast se ka vend do të kërkohet ndjekje penale në bazë të dispozitave të Kodit Penal.
5. Ky urdhër ju njoftohet palëve të cilat në bazë të nenit 610 të K.Pr.Civile, kanë të drejtën e ankimit në gjykatën e rrethit gjyqësor të vendit të ekzekutimit brenda 5 ditëve nga marrja dijeni.

Studio Permbarimore "DE NOVO" shpk  
PËRMBARUESI GJYQËSOR  
Klodiana TABAJ

  
